

Puna praktike e studentëve lidhur me motivimin e fëmijëve

Violeta Buza, Dr. Kolegji AAB

E-mail: violeta.buza@aab-edu.net

Abstrakt

Krijimi i një klime të mirë në klasë arrihet nëpërmjet ndërlidhjes së lëndëve mësimore dhe aktiviteteve kreative me fëmijët, të cilat ndikojnë në motivimin dhe zhvillimin e kompetencave kryesore të të nxënit të tyre, me qëllim që të kuptojnë më lehtë botën që i rrethon. Andaj, si rezultat i bashkëpunimit mes institucioneve arrihet planifikimi dhe realizimi i praktikës nga studentët edukatorë me qëllim të vetëdijësimit të tyre për punën me fëmijë gjatë studimeve. Proces i rëndësishëm mbetet analizimi i punës së studentëve edukatorë gjatë marrjes së informacioneve teorike dhe realizimit të praktikës në institucionet parashkollore dhe klasat përgatitore në shkolla për motivimin e fëmijëve për të nxënë. Ky punim vë në pah punën e studentëve edukatorë në lëndët “Teori e Mësimimit me Praktikë” dhe “Praktika Pedagogjike” për planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme në bashkëpunim me edukatorët në institucionet parashkollore dhe klasa përgatitore. Andaj mendojmë se ndërlidhja e teorisë me praktikën ndikon në punën kreative të studentëve për motivimin dhe zhvillimin e fëmijëve. Analiza studimore është mbështetur në analizën e ditareve e të portofoliove, si dhe në hulumtimet e prezantimet e studentëve edukatorë të Kolegjit AAB. Puna praktike është realizuar në institucionet parashkollore dhe klasat përgatitore për pesëmbëdhjetë javë nga studentët e vitit të dytë dhe vitit të katërt të Shkencave Sociale për vitin akademik 2017/2018.

Fjalë kyçe: *praktika, motivimi, zhvillimi i fëmijëve, ditari, portofolio.*

Motivimi i fëmijëve dhe zhvillimi i kompetencave kryesore të tyre është aspekt i vështirë dhe pjesë shumë e rëndësishme e punës së edukatoreve në procesin mësimor, sepse një fëmijë i pamotivuar për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme mësimore mund të ketë edhe vështirësi në të mësuar. Fëmijët duhet të motivohen gjithmonë për mësim të përjetshëm, sepse “motivimi për të nxënëit është i brendshëm, i nxitur nga metodat aktive të të nxënëit” (Walsh, Kiranxhiska & Gjorgjieva, n.d. a.d., 16), pra duhet siguruar një mjedis i përshtatshëm për moshën dhe zhvillimin e tyre, duke instaluar tek ata kreativitetin për të arritur te të nxënëit e suksesshëm.

Duke parë që puna e edukatores është punë me përgjegjësi për zhvillimin e fëmijëve duhet t’i kushtohet rëndësi sa informacioneve teorike, ashtu edhe praktikës profesionale të studentëve gjatë viteve të studimeve si një rrugë e vështirë në punën me fëmijë, por e arritshme. “Do të arrijmë të formojmë mësimdhënës bashkëkohorë, mësimdhënës që arrijnë t’i përmbushin kërkesat e nxënësve, vetëm atëherë kur mësimi teorik dhe praktik do të jenë të mpleksur fuqishëm njëri me tjetrin” (Winsor 2004b, v). Mësimi praktik është një sfidë për studentët edukatorë, duke filluar nga marrja e informacioneve teorike gjatë katër viteve të studimeve dhe realizimit të tri viteve praktikë në institucione të ndryshme parashkollore dhe klasa përgatitore, ku pajisen me modele e përvoja të ndryshme të mësimdhënies nga edukatorët. Praktika është burim i vërtetë i dijes dhe me të drejtë quhet përvojë e mësuesve, sepse mësuesit marrin vendim të trajtojnë programet mësimore, përcaktojnë objektivat, përgatisin materialin për temat e planifikuara, organizojnë klasën dhe zbatojnë veprimtarinë mësimore (Zajazi, 2003). Kjo përvojë do t’u shërbejë studentëve edukatorë si përgatitje për profesionin e ardhshëm gjatë punës me fëmijë pasi thuhet se edukatorja lehtëson punën, zëvendëson prindin e bëhet një mike e dashur për fëmijët.

Edukatorja është si një thesar me informacione të shumta që arrin të jetë efektive si në shkretëtirë, ashtu dhe në oqean ose nën një pemë në majën e malit (Reynolds, 2001).

Roli i studentëve në institucionet parashkollore dhe klasat përgatitore është shumë i madh në procesin e të nxënimit të fëmijëve. Ata duhet të arrijnë t'i frymëzojnë fëmijët dhe të ndikojnë në motivimin e tyre nëpërmjet planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve të përshtatshme mësimore. Po ashtu, komunikimi i hapur me prindërit për një bashkëpunim të mirëfilltë me edukatorët dhe studentët edukatorë ndikon pozitivisht në rritjen e efektivitetit mësimor pasi "prindërit dhe mësuesit duhet të njohin rëndësinë plotësuese të njëri-tjetrit në jetën e nxënësit" (M. Fullan, Forcat e ndryshimit 2002, 319).

Qëllimi i studimit është analizimi i punës së studentëve edukatorë gjatë marrjes së informacioneve teorike dhe realizimit të praktikës në institucionet parashkollore e klasat përgatitore për motivimin dhe zhvillimin e fëmijëve në të gjitha fushat e jetës, për të arritur të përfundimi se ndërlidhja e teorisë me praktikën luan rol të rëndësishëm në punën kreative të vetë studentëve për motivimin dhe zhvillimin e fëmijëve.


Konteksti teorik

Bazuar në Kornizën Kurrikulare të Kosovës parashihet të nxënimit e integruar nëpërmjet fushave kurrikulare duke i kontribuar zhvillimit të kompetencave dhe të rezultateve të të nxënimit të fëmijët që të shkathtësohen për jetë. Gjashtë kompetencat kryesore, të cilat duhet të arrihen nga fëmijët gjatë arsimit parauniversitar janë: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit; Kompetenca e të menduarit; Kompetenca e të mësuarit; Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis; Kompetenca personale dhe Kompetenca qytetare, për të arritur

te rezultati përfundimtar, që të jenë: komunikues efektivë, mendimtarë kreativë dhe kritikë, nxënës të suksesshëm, kontribues produktivë, individë të shëndoshë dhe qytetarë të përgjegjshëm si një zhvillim i pavarur i personalitetit të fëmijëve (MASHT, 2016).

Sipas moshës së fëmijëve duhet të planifikohen dhe të realizohen aktivitete apo lojëra të përshtatshme në arsimin parashkollor që të arrihet sukses në të gjashtë fushat e zhvillimit të tyre, duke filluar nga zhvillimi i gjuhës, zhvillimi i matematikës, edukimi artistik, zhvillimi social dhe personal, zhvillimi shkencor dhe zhvillimi fizik e shëndetësor. Nëpërmjet lojës, si aktivitet themelor, dhe punës zbavitëse me fëmijë rritet produktiviteti i kujtesës dhe i imagjinatës së tyre në mënyrë të qëllimshme për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm (Zuna, Edukimi i parashkollorit në familje 2003). Është e nevojshme të grumbullohen materiale të nevojshme për zhvillimin e aftësive të tyre krijuese dhe bashkëpunuese te secili kënd i punës në klasë.

Figura 1. Organizimi i klasës



(Walsh, Kiranxhiska & Gjorgjieva, n.d. a.d., 85)

Struktura e klasës, sipas Fig. 1, duhet të jetë e rregulluar në formën e të punuarit në grupe të vogla e jo në formën individuale të punës në mënyrë që fëmijët të bashkëpunojnë mes vete, të motivohen nga njëri-tjetri për arritjen e rezultateve pozitive. Kjo formë e punës i ndihmon fëmijët të punojnë në mënyrë aktive, stimulon nxitjen e ideve të ndryshme për zgjidhjen e problemeve duke iu krijuar mundësi për rrugë të reja njohjeje nëpërmjet bashkëveprimit me njëri-tjetrin (Cekani, 2010).

Komponenti i Mësimit praktik, si pjesë e programit për përgatitjen e edukatorëve, do t'u ofrojë studentëve mundësi të vëzhgojnë modele të mësimit, të angazhohen në mësime, të pranojnë udhëzime konstruktive dhe të mësojnë për mësime të tyre si edukatorë e si vetëvlerësues reflektivë (Winsor 2004a, 1).

Varësisht nga bashkëpunimi me edukatorët, studentët arrijnë të planifikojnë dhe të realizojnë aktivitete të ndryshme

në institucione parashkollore dhe klasa përgatitore, andaj themi se Mësimi praktik në Fakultet ka dy qëllime kryesore:

1. T'u ofrojë studentëve *përgatitjen* që u duhet atyre për të qenë të suksesshëm në klasa, dhe

2. T'u ofrojë atyre kohë dhe strukturë për *reflektim dhe diskutim*, për ta mundësuar nxënien nga koha që kanë kaluar në klasë (Winsor 2004a, 2).

Prandaj studentët duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për punën me fëmijë duke filluar nga planet mësimore, zbatimi i tyre në klasa, aktivitetet dhe lojërat e ndryshme që duhen zhvilluar në klasë për krijimin e një mjedisi sa më motivues për fëmijët, sepse "loja është shpirti i çdo programi mësimor të fëmijërisë së hershme" (Coughlin et al 1997, I-13).

Metodologjia

Në këtë studim është shfrytëzuar metoda sasiore dhe cilësore. Si instrument i hulumtimit është përdorur ditari i plotësuar i studentëve dhe portofolio e tyre për punën praktike të realizuar në klasat përgatitore dhe institucionet parashkollore, i cili është përdorur edhe për vlerësimin e punës së tyre me fëmijë të planifikuar dhe i realizuar për 15 ditë pune. Është plotësuar sipas strukturës së dhënë, të cilat duhet të përmbanin planet vjetore, mujore, javore e ditore; formën e vëzhgimit në klasë të një fëmije me vështirësi; fotot e aktiviteteve dhe formave të punës me fëmijë si dhe materialet të cilat i kanë punuar dhe përdorur për konkretizimin e mësimin. Puna e studentëve është realizuar kryesisht në institucionet parashkollore dhe klasat përgatitore në komunën e Prishtinës dhe komunën e Gjakovës. Duke pasur parasysh rëndësinë e planifikimit dhe të organizimit të mësimin nga edukatorët dhe studentët edukatorë për arritjen e një suksesi të plotë të fëmijët (Musai, 2014),

studentët janë këshilluar për planifikimin dhe realizimin e një prezantimi bazuar në punën e tyre në klasa gjatë një dite të praktikës, sipas orarit të marrë nga edukatorët në lëndët e ndryshme mësimore.

Prezantimet e punës së realizuar në klasat ku bënin praktikën kanë arritur rezultat pozitiv në motivimin e vetë studentëve, duke parë aktivitete të ndryshme nga njëri- tjetri dhe duke planifikuar sa më shumë aktivitete atraktive, duke arritur të fëmijët sa më shumë sukses në të nxënë cilësor e, po ashtu, të jenë konkurrentë mes vete në prezantimin sa më të mirë të punës së tyre.

Kjo formë e hulumtimit u zgjodh me qëllim të të vërejturit të punës kreative të studentëve për pjesëmarrje në orët mësimore, në mbledhjen e informacioneve për një fëmijë me vështirësi në të nxënë pa e kuptuar fëmija se është në vëzhgim, sepse “është e rëndësishme që të regjistrohet ajo që realisht është *parë* në vend të asaj që ne *mendojmë* se kemi parë” (Glenn, Cousins & Helps 2006), si dhe motivimin dhe shkathtësimin e fëmijëve për jetë nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve edukatorë në klasa. Ky hulumtim bazohet në rëndësinë e planifikimit sipas Kurrikulës së re në arritjen e rezultateve të të nxënit të fëmijët. Kampioni është i qëllimshëm, mostra përfshin 158 studentë të Kolegjit AAB në qendrat Prishtinë dhe Gjakovë.

Të dhënat janë mbledhur nga analiza e 132 ditarëve dhe portofoliove që janë plotësuar nga studentët e vitit të katërt gjatë praktikës dhe 28 prezantimeve të punës së tyre të realizuar në institucionet parashkollore dhe klasat përgatitore për pesëmbëdhjetë ditë. Po ashtu, prezantimet e 26 studentëve të vitit të dytë, të cilët krahas ligjëratave kanë realizuar detyrat e dhëna sipas planprogramit, duke përzgjedhur një njësi nga teoria për ta aplikuar në orët mësimore, në institucionet parashkollore dhe klasat përgatitore. Bazuar në ndërlihdjen e teorisë së marrë nga temat e ligjëruara për pesëmbëdhjetë javë

me praktikën e realizuar me ndihmën e edukatoreve në klasa me fëmijët, është arritur që vetë studentët të jenë më kreativë në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve, me qëllim që të jenë sa më afër krijimit të një lidhjeje të qëndrueshme me fëmijët në realizimin e qëllimit.

Rezultati

Të dhënat na ndihmojnë të japim një vlerësim për punën e studentëve edukatorë që kanë realizuar gjatë praktikës në institucionet parashkollore dhe klasat përgatitore me fëmijët në komunën e Prishtinës dhe komunën e Gjakovës. Bazuar në rezultatin e të dhënave vërejmë se përgatitja e studentëve nga ana teorike dhe ndihma e edukatoreve për punën e tyre gjatë praktikës ndihmon pozitivisht në përgatitjen e tyre për punë të suksesshme me fëmijë. Po ashtu, sukcesi i tyre vërehet në planifikimin dhe realizimin e suksesshëm të aktiviteteve dhe të lojërave të ndryshme, në motivimin e fëmijëve për të nxënë të suksesshëm, në arritjen e rezultateve të fëmijët si dhe vetë studentët pas përfundimit të studimeve që të arrijnë deri te punësimi i tyre më lehtë nëpërmjet angazhimit për punë të suksesshme.

Ky studim është bazuar në punën e studentëve edukatorë të realizuar gjatë pesëmbëdhjetë javëve të ligjëratave dhe në detyrat që kanë realizuar në lëndët “Teori e Mësimit me Praktikë” dhe “Praktika Pedagogjike” për planifikimin e punës dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme në bashkëpunim me edukatorët në institucione parashkollore dhe klasa përgatitore në shkolla.

Nga rezultatet e fituara do të arrijmë të përfundimet se është me rëndësi që t’i kushtohet kujdes ndërlidhjes së teorisë dhe realizimit të praktikës me qëllim të vetëdijësimit të studentëve

për punën me fëmijë, ndërlidhjes së lëndëve mësimore, planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve kreative për motivimin e fëmijëve në zhvillimin e kompetencave kryesore të të nxënit.

Tabela 1. Vëzhgimi i fëmijës

Observimi i fëmijës

| | | Frekuenca | Përqindja | Përqindja valide | Përqindja kumulative |
|----------|-------|-----------|-----------|------------------|----------------------|
| vlefshëm | 0 | 56 | 42.4 | 42.4 | 42.4 |
| | 1 | 45 | 34.1 | 34.1 | 76.5 |
| | 2 | 15 | 11.4 | 11.4 | 87.9 |
| | 3 | 2 | 1.5 | 1.5 | 89.4 |
| | 5 | 1 | .8 | .8 | 90.2 |
| | 6 | 3 | 2.3 | 2.3 | 92.4 |
| | 7 | 1 | .8 | .8 | 93.2 |
| | 8 | 1 | .8 | .8 | 93.9 |
| | 9 | 1 | .8 | .8 | 94.7 |
| | 12 | 2 | 1.5 | 1.5 | 96.2 |
| | 13 | 1 | .8 | .8 | 97.0 |
| | 14 | 1 | .8 | .8 | 97.7 |
| | 15 | 1 | .8 | .8 | 98.5 |
| | 16 | 2 | 1.5 | 1.5 | 100.0 |
| | Total | 132 | 100.0 | 100.0 | |

Në detyrën e dhënë që, gjatë praktikës, studentët të realizojnë një observim - vëzhgim të një fëmije se si sillet dhe sa është i përgatitur për qëndrim në orën mësimore vërejmë se 56 studentë ose 42.42% nuk e kanë realizuar detyrën fare, 45 studentë ose 34.1% e kanë planifikuar dhe e kanë realizuar observimin duke shkruar vetëm një përshkrim, ndërsa 31 studentë apo 23.48% kanë shkruar më shumë se dy përshkrime për vëzhgimin e realizuar.

Andaj, bazuar në rezultatet e studimit sipas tabelës 1, kuptojmë se 76 studentë ose 57.58% e kanë realizuar vëzhgimin

e fëmijës gjatë pesëmbëdhjetë ditëve të praktikës duke i përshkruar vështirësitë e tyre, formën dhe metodat e punës së realizuar me ata fëmijë, duke treguar përparësitë, arritjet, ngeçjet dhe vështirësitë pas kyçjes së tyre në procesin mësimor.

Studentët, të cilët kanë realizuar observimin - vëzhgimin, kanë arritur të pasqyrojnë forma të ndryshme të përshkrimeve të fëmijëve; disa kanë shkruar në formën e përgjithshme apo përshkruese fëmijën vetëm me një faqe, ndërsa disa të tjerë kanë realizuar çdo ditë përshkrim të detajizuar të planifikimit dhe të realizimit të aktiviteteve lidhur me zhvillimin e fëmijës në arritjen e kompetencave e rezultateve pozitive. Përshkrimet, të cilat janë shkruar më detajisht, u referohen fëmijëve më të heshtur, fëmijëve me vështirësi në komunikim, fëmijëve me dëmtim intelektual e fëmijëve më pak të socializuar. Po ashtu, në përshkrimet e studentëve edukatorë gjejmë angazhimin e realizuar nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme me fëmijët me vështirësi që të arrijnë një përparim më të madh gjatë kohës së praktikës në institucionet parashkollore dhe klasat përgatitore. Nga të dhënat arrijmë të kuptojmë se ndihma e ofruar nga ana e studentëve edukatorë ka sjellë pozitivitet te fëmijët me vështirësi lidhur me motivimin për arritjen e rezultateve sa më të mira dhe në ndryshimin e sjelljeve, pasi afërsisht 58% e tyre tregojnë se si dhe sa kanë qenë të motivuar fëmijët në kohën e pjesëmarrjes së studentëve edukatorë në institucionet parashkollore dhe klasat përgatitore. Njëherazi, angazhimi i studentëve edukatorë reflekton pozitivitet edhe për edukatorët, sepse puna është më e suksesshme me dy edukatore në klasë.

Tabela 2. Aktivitete në punë në grupe

Aktivitete në punë në grupe

| | Frekuenca | Përqindja | Përqindja valide | Përqindja kumulative |
|------------|-----------|-----------|------------------|----------------------|
| vlefshëm 0 | 29 | 22.0 | 22.0 | 22.0 |
| 1 | 8 | 6.1 | 6.1 | 28.0 |
| 2 | 14 | 10.6 | 10.6 | 38.6 |
| 3 | 12 | 9.1 | 9.1 | 47.7 |
| 4 | 13 | 9.8 | 9.8 | 57.6 |
| 5 | 11 | 8.3 | 8.3 | 65.9 |
| 6 | 4 | 3.0 | 3.0 | 68.9 |
| 7 | 3 | 2.3 | 2.3 | 71.2 |
| 8 | 6 | 4.5 | 4.5 | 75.8 |
| 9 | 1 | .8 | .8 | 76.5 |
| 10 | 5 | 3.8 | 3.8 | 80.3 |
| 11 | 4 | 3.0 | 3.0 | 83.3 |
| 12 | 3 | 2.3 | 2.3 | 85.6 |
| 13 | 3 | 2.3 | 2.3 | 87.9 |
| 14 | 2 | 1.5 | 1.5 | 89.4 |
| 16 | 2 | 1.5 | 1.5 | 90.9 |
| 17 | 1 | .8 | .8 | 91.7 |
| 18 | 2 | 1.5 | 1.5 | 93.2 |
| 19 | 2 | 1.5 | 1.5 | 94.7 |
| 23 | 2 | 1.5 | 1.5 | 96.2 |
| 25 | 1 | .8 | .8 | 97.0 |
| 26 | 1 | .8 | .8 | 97.7 |
| 27 | 1 | .8 | .8 | 98.5 |
| 30 | 1 | .8 | .8 | 99.2 |
| 31 | 1 | .8 | .8 | 100.0 |
| Total | 132 | 100.0 | 100.0 | |

Nga të dhënat e nxjerra sipas tabelës 2, kuptojmë se 29 studentë apo 22% nuk e kanë aplikuar punën në grupe, e cila konsiderohet si forma më e përshtatshme e realizimit të aktiviteteve me fëmijë, ndërsa 103 studentë apo 78% e kanë aplikuar këtë formë të punës me fëmijë. Kuptojmë se afro 52% e kanë realizuar këtë formë të punës më shumë se katër herë gjatë

punës praktike dhe se kanë arritur mjaft bashkëpunim mes fëmijëve, realizim të detyrave me kohë dhe saktë, realizimin e planit mësimor përfshirë aktivitetet apo lojërat e përshtatshme për zhvillimin e fëmijëve në arsimin parashkollor.

Një ndër arsytet e pak studentëve edukatorë, të cilët nuk e kanë aplikuar formën e punës në grupe ishte se edukatorët i kanë penguar dhe nuk kanë lejuar të aplikohet kjo formë e punës me arsyetimin se është e pamundur pasi klasat janë të vogla, andaj kanë aplikuar më shumë formën e punës tradicionale.

Figura 2. Puna e fëmijëve e realizuar në qendra

Figura 2.1. Kalendari vjetor Figura 2.2. Qendra e shkencës



Figura 2.3. Ndërtimi i urës **Figura 2.4. Qendra e matematikës**



Foto të realizuara nga studentët gjatë punës praktike në institucionet parashkollore dhe klasat përgatitore

Fotot nga fig.2 na tregojnë punën e studentëve edukatorë, të cilët kanë planifikuar dhe realizuar aktivitete në lëndë të ndryshme me fëmijë gjatë punës praktike. Fotoja e parë (2.1) paraqet aktivitetin rutinë ditore, të cilin e realizojnë çdo ditë me qëllimin e të mbajturit mend dhe rikujtimin e informacioneve të nevojshme duke filluar nga ditët e javës, muajt e vitit, stinët, motin dhe datat. Fotoja e dytë (2.2) paraqet punën e fëmijëve në grupe në qendrën e shkencës ku me anë të mjeteve, ngjyrave e formave të ndryshme arrijnë të jenë kreativë në punën e tyre bashkëpunuese. Fotoja e tretë (2.3) paraqet ndërtimin e urës nëpërmjet mjeteve ricikluese në lëndën e gjuhës angleze ku fëmijët komunikojnë mes vete dhe me edukatoren duke mësuar për mjetet e nevojshme të punës, materialet ndërtimore, rëndësinë e urës, gjatësinë dhe lartësinë e saj, si dhe informacione të tjera me rëndësi; ndërsa fotoja e katërt (2.4) paraqet qendrën e matematikës ku janë përgatitur mjetet e konkretizimit që shërbejnë në mbajtjen mend të numrave, ngjyrave, formave gjeometrike, materialeve etj. Të gjitha aktivitetet e realizuara në qendrat e ndryshme i ndihmojnë fëmijët të shohin, të prekin, të mendojnë, të rikujtojnë, të

planifikojnë dhe të realizojnë objekte të ndryshme, të cilat i shërbejnë përgatitjes dhe zhvillimit të tyre në të gjitha fushat. Disa nga aktivitetet e realizuara për nxitjen e të mësuarit janë dhënë te libri *Metodika sipas fushave të zhvillimit* që të ndihmojnë fëmijët të arrijnë suksese dhe praktika të reja (Cekani, 2012).

Tabela 3. Materialet e përdorura për konkretizim

| Materialet e përdorura për konkretizim | | | | | |
|--|-------|-----------|-----------|------------------|----------------------|
| | | Frekuenca | Përqindja | Përqindja valide | Përqindja kumulative |
| vlefshëm | 0 | 17 | 12.9 | 12.9 | 12.9 |
| | 1 | 6 | 4.5 | 4.5 | 17.4 |
| | 2 | 4 | 3.0 | 3.0 | 20.5 |
| | 3 | 5 | 3.8 | 3.8 | 24.2 |
| | 4 | 10 | 7.6 | 7.6 | 31.8 |
| | 5 | 4 | 3.0 | 3.0 | 34.8 |
| | 6 | 7 | 5.3 | 5.3 | 40.2 |
| | 7 | 7 | 5.3 | 5.3 | 45.5 |
| | 8 | 6 | 4.5 | 4.5 | 50.0 |
| | 9 | 1 | .8 | .8 | 50.8 |
| | 10 | 9 | 6.8 | 6.8 | 57.6 |
| | 11 | 6 | 4.5 | 4.5 | 62.1 |
| | 12 | 4 | 3.0 | 3.0 | 65.2 |
| | 13 | 4 | 3.0 | 3.0 | 68.2 |
| | 14 | 6 | 4.5 | 4.5 | 72.7 |
| | 15 | 4 | 3.0 | 3.0 | 75.8 |
| | 16 | 10 | 7.6 | 7.6 | 83.3 |
| | 17 | 5 | 3.8 | 3.8 | 87.1 |
| | 18 | 2 | 1.5 | 1.5 | 88.6 |
| | 19 | 3 | 2.3 | 2.3 | 90.9 |
| | 21 | 1 | .8 | .8 | 91.7 |
| | 24 | 1 | .8 | .8 | 92.4 |
| | 26 | 3 | 2.3 | 2.3 | 94.7 |
| | 27 | 1 | .8 | .8 | 95.5 |
| | 32 | 2 | 1.5 | 1.5 | 97.0 |
| | 33 | 1 | .8 | .8 | 97.7 |
| | 43 | 1 | .8 | .8 | 98.5 |
| | 54 | 1 | .8 | .8 | 99.2 |
| | 56 | 1 | .8 | .8 | 100.0 |
| | Total | 132 | 100.0 | 100.0 | |

Lidhur me materialet e punuara nga vetë studentët dhe të përdorura për konkretizimin e njësive mësimore, nga të dhënat sipas tabelës 3 kuptojmë se vetëm 17 studentë apo 12.9% nuk kanë planifikuar e punuar mjete konkretizimi, ndërsa 115 studentë apo 73% kanë përdorur materialet dhe mjetet e konkretizimit për qartësimin e njësive mësimore dhe motivimin e fëmijëve për zhvillimin e tyre lidhur me arritjen e kompetencave dhe të rezultateve pozitive në të nxënë. Mbi 70% e studentëve tregojnë se kanë përdorur më shumë se tri materiale gjatë punës praktike. Disa prej tyre tregojnë se edhe edukatorët i kanë ndihmuar studentët edukatorë duke i orientuar në punimin e materialeve për konkretizim, si dhe duke i ndihmuar në përgatitjen e tyre që studentët t'i aplikojnë në klasë duke e bërë mësimin sa më atraktiv e më motivues për fëmijët në arritjen e një pune të suksesshme.

Duke u bazuar te të tria tabelat e mësipërme dhe analiza sasiore e përftuar kuptojmë se përqindja më e madhe u referohet studentëve edukatorë, të cilët kanë arritur rezultatet e planifikuara në bashkëpunim me edukatorët me qëllim të motivimit dhe zhvillimit të fëmijëve.

Tabela 4. Korrelacioni ndërmjet aktiviteteve të realizuara gjatë formave të ndryshme të punës me nxënës: në grupe, individuale dhe frontale

Korrelacionet

| | Aktivitete në punë në grupe | Aktivitete në punë individuale | Aktivitete në punë frontale |
|--------------------------------|-----------------------------|--------------------------------|-----------------------------|
| Aktivitete në punë në grupe | 1 | .527** | .618** |
| Korrelacioni Pearson | | | |
| Sig. (2-pjesësh) | | .000 | .000 |
| N | 132 | 132 | 132 |
| Aktivitete në punë individuale | .527** | 1 | .445** |
| Korrelacioni Pearson | | | |
| Sig. (2-pjesësh) | .000 | | .000 |
| N | 132 | 132 | 132 |
| Aktivitete në punë frontale | .618** | .445** | 1 |
| Korrelacioni Pearson | | | |
| Sig. (2-pjesësh) | .000 | .000 | |
| N | 132 | 132 | 132 |

** . Korrelacioni është domethënës në nivelin 0.01 (2-pjesësh).

Sipas të dhënave në tabelën 1.4 vërejmë korrelacionin mes aplikimit të formave të ndryshme të punës në klasë nga studentët edukatorë ($r=+0.527$; $r=+0.618$; $p=0.01$). Përkundër njohurive nga ana teorike që mbështesin pikëpamjen se forma e punës në grupe – qendra është më e suksesshme në klasat parashkollore, vërehet ende aplikimi i formës frontale dhe asaj individuale, të cilat i takojnë më shumë formës tradicionale të punës. Megjithatë, nga të dhënat arrihet të kuptohet se

aktivitetet e planifikuara pothuajse në të gjitha lëndët mësimore janë realizuar më shumë në formën e punës në grupe për të konkretizuar sa më mirë njësitë mësimore e për të nxitur motivimin, socializimin dhe zhvillimin e fëmijëve, ndërsa është realizuar më pak forma frontale dhe individuale, kryesisht rreth të kuptuarit të informacioneve të përgjithshme gjatë aktiviteteve rutinë, zhvillimit të lojërave e vizatimeve të ndryshme me fëmijë, gjatë mbjelljes së luleve dhe realizimit të aktiviteteve të tjera të suksesshme.

Sipas të dhënave cilësore nga studentët edukatorë për këtë studim arrijmë të kuptojmë se:

Tabela 5. Rezultatet e studentëve për punën e planifikuar

| | |
|--|--|
| Nga arritja e rezultateve të planifikuara në një ditë mësimi, studentët edukatorë vërejtën tek fëmijët se: | E kuptuan tregimin e mësuar, dhe me fjalët e tyre e ritreguan atë |
| | E dalluan ujin e nxehtë dhe të ftohtë |
| | U përfshinë të gjithë fëmijët në lëndën e edukatës fizike dhe kur arrinin të bënëin aktivitetin ndiheshin shumë të lumtur. |
| | U argëtuan shumë nëpërmjet lojërave të realizuara |
| | U arrit qëllimi i aktivitetit që fëmijët të njihen me insektet dhe të realizojnë prerjen, sepse kishin vështirësi. |
| | Me aktivitetin e realizuar në natyrë fëmijët mësuan shumë shpejt t'i ndajnë insektet fluturuese dhe jofluturuese, madje i kapën edhe me duar pa u frikësuar. |
| | Fëmijët arritën të kuptojnë kohën kur |

| | |
|--|--|
| | fillon dita dhe kohën kur është nata |
| | Fëmijët treguan kohën (orën) kur zgjohen, kur nisen për shkollë, kohën e përfundimit të mësimit dhe kohën kur shkojnë në shtrat |
| | Fëmijët arritën të kuptojnë përrallën, ta luajnë në role dhe të vizatojnë personazhet e përrallës |
| Studentët kanë arritur të kuptojnë se menaxhimi i mirë i klasës: | Arrihet duke zhvilluar aktivitete atraktive dhe interesante për fëmijët |
| | Arrihet nga bashkëpunimi mes mësimeve për të arritur të planifikimi i mirë i planeve vjetore, mujore, javore e ditore |
| | Arrihet nëpërmjet krijimit të ambientit të mirë, hapësirës së mjaftueshme të klasës dhe ndriçimit për realizimin e aktiviteteve mësimore |
| | Arrihet nëpërmjet aplikimit të mënyrave të reja mësimore shumë frymëzuese nga edukatorja |
| | Arrihet nga përgatitja dhe plotësimi i dosjeve në mënyrë sistematike për secilin fëmijë |
| | Arrihet nga përshtatja e formave, metodave, teknikave dhe mjeteve për temat mësimore |
| | Arrihet nëpërmjet aplikimit të lojës, sepse nxit zhvillimin e fëmijës |
| | Arrihet nëpërmjet realizimit me vullnet dhe sukses të punës praktike, e cila është motivim për vetë studentët dhe përvojë e mirë për fëmijët |
| | Ndihmon në realizimin e aktiviteteve në natyrë, pasi është shumë i dobishëm |

| | |
|---|--|
| | për ndërlidhjen e teorisë me praktikën |
| | Nënkupton ndarjen e fëmijëve në grupe – qendra për realizimin e detyrave të planifikuara |
| Studentët kanë arritur nga vëzhgimi i fëmijëve në klasë që: | Vetë si mësime të jenë më të vëmendshëm në përcjelljen e fëmijëve gjatë ditës |
| | Të realizojnë planifikim vjetor, mujor, javor, ditor dhe të analizojnë planin individual për fëmijët me vështirësi |
| | Të përcjellin dhe të ndihmojnë fëmijët që kanë vështirësi në të nxënë gjatë aktiviteteve që realizojnë |
| | Të përcjellin dhe të ndihmojnë fëmijët që ndryshojnë sjelljen gjatë aktiviteteve që realizojnë |
| | T’u kthejnë vëmendjen fëmijëve hiperaktivë në përcjelljen dhe realizimin e aktiviteteve |
| | T’u përmirësojnë shqiptimin e shkronjave dyshe: rr, sh, nj, dh, th |

Pra, nga të dhënat cilësore është arritur në përfundim se është shumë i rëndësishëm menaxhimi i mirë i klasës, planifikimi i mirë dhe realizimi i suksesshëm i planit në arritjen e rezultateve të fëmijët e, po ashtu, edhe në ofrimin e ndihmës fëmijëve me vështirësi të ndryshme për t’u përfshirë në procesin mësimor.

Diskutime

Gjatë realizimit të praktikës studentët edukatorë kishin një bashkëpunim të mirë me edukatorët, angazhonin të gjithë fëmijët për pjesëmarrje në aktivitete, aplikonin forma të

ndryshme të punës e në veçanti formën e punës në grupe, ndërsa fëmijët ishin shumë të lumtur që merrnin pjesë në aktivitete atraktive. Disa nga aktivitetet e realizuara për nxitjen e kureshtjes dhe zhvillimin e fëmijëve në lëndë të ndryshme tregojnë se vetë studentët edukatorë duhet të jenë të përgatitur për planifikimin e mësimit, të mbështeten në përvojën e edukatores e të mbështesin fëmijët duke i përshtatur aktivitetet për moshën e tyre që të bëhen të pavarur. Nga prezantimi i punës së studentëve edukatorë kuptojmë se fëmijët i duan ndryshimet dhe lojërat atraktive e, po ashtu, të gjithë kanë shfaqur dëshirë që të provojnë aktivitetet e realizuara. Këtë e dëshmojnë dhe disa nga përshtypjet e studenteve edukatore të pasqyruara më poshtë:

“Të gjithë fëmijët u veshën me rrobat që u kisha sjellë dhe të gjithë me radhë e ushtronin profesionin e mjekut. Aktiviteti u ndërlihdh me zhvillimin emocional si dhe kreativitetin. Po ashtu u realizua ndërlidhja mes lëndëve mësimore” – Agnesa

“Gjatë aktiviteteve fëmijët ishin të lumtur dhe të interesuar për pjesëmarrje e në veçanti në vendosjen e ngjyrave të semaforëve” – Shpresa

“Fëmijët ishin në gjendje të realizonin secilin aktivitet me sukses. Isha shumë e kënaqur me punën e tyre” – Jetlira

“Sjellja e edukatores me fëmijët ishte shumë korrekte dhe frytdhënëse; menaxhimi ishte në nivelin e duhur, ndaj dhe zënkat e vogla mes fëmijëve përfundonin me përqaftim dhe kërkimfalje ndaj njëri-tjetrit”; “Raporti im me fëmijët ka qenë shumë i ngrohtë; vështirësitë i kam tejkaluar me ndihmën e edukatores. Të punosh me fëmijë është kënaqësi e vërtetë” – Fitorja

“Me anë të kësaj pune praktike kam arritur të fitoj njohuri dhe aftësi të reja dhe në të njëjtën kohë përfitim të aftësive të punës në grup. Kjo punë praktike më ka ndihmuar të arrij të

krijoj një bazë solide të njohurive që do të më mundësojnë përgatitjen e mëtutjeshme” - Valdona

Përfundime dhe rekomandime

Studimi tregon qartë se motivimi i studentëve edukatorë në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve në institucionet parashkollore dhe klasat përgatitore luan rol të rëndësishëm në realizimin me sukses të praktikës. Bazuar në rezultatet e studimit vlen të theksohet se mbështetja e studentëve në ndërlidhjen e anës teorike me atë praktike përcjell te fëmijët pozitivitet në punën kreative në klasa me qëllim të motivimit të drejtë dhe të zhvillimit të tyre në të gjitha fushat për formimin e personalitetit. Rezultatet e këtij studimi tregojnë për suksesin e studentëve gjatë punës praktike, duke arritur realizimin e detyrës së tyre me sukses, si dhe në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm mësimor për fëmijët, duke filluar nga planifikimi i punës me fëmijë, bashkëpunimi me edukatoren, realizimi i aktiviteteve të përshtatshme për motivimin dhe zhvillimin e fëmijëve, si dhe ndihmën e ofruar gjatë vëzhgimit të fëmijëve me vështirësi të ndryshme.

Njëra nga studentet ka treguar se duke u bazuar në punën e realizuar me shumë përkushtim në klasë me fëmijët e, në veçanti, në vëzhgimin dhe ndihmën e ofruar fëmijës me vështirësi gjatë punës praktike është ftuar nga prindërit e fëmijës që ta punësojnë si asistente (ndihmëse) në klasë me qëllim që ta ndihmojnë fëmijën në përparimin më të shpejtë të tij dhe ta ndihmojnë edukatoren në klasë që të arrijë t’u ndihmojë gjithë fëmijëve.

Themi se angazhimi i përbashkët për bashkëpunim ndërmjet institucioneve për ndarjen e përvojave të mira mësimore sjell gjithmonë rezultate pozitive, ndaj të gjithë personat e përfshirë

në arsim duhet të japin maksimumin e mundshëm në krijimin e një mjedisi të ngrohtë e të përshtatshëm mësimor për motivimin dhe angazhimin e fëmijëve si rezultat i zhvillimit të tyre në kohën e duhur.

Referencat

Blades et al. (2005). *Libri me udhëzime për Situatat me Nxënësin në Qendër*. Prishtinë: KEDP.

Cekani, E. H. (2010). *Libri i mësueses së arsimit parashkollor*. Tiranë: Polis.

Cekani, E. H. (2012). *Metodika sipas fushave të zhvillimit*. Tiranë: Polis.

Coughlin et al. (1997). *Hap pas Hapi: Një program për fëmijët dhe familjet: Krijimi i klasave me fëmijët në epiqendër: fëmijët 3-5 vjeçarë*. Uashington, D.C: Organizata Ndërkombëtare e Burimeve për Fëmijë.

Fullan, M. (2002). *Forcat e ndryshimit*. Tiranë.

Glenn, A., Cousins, J. & Helps, A. (2006). *Eliminimi i Pengesave në të nxënë në Moshën e Hershme*. London: David Fulton.

Kaza, N. (2009). *Motivimi dhe mësimdhënia*. Tiranë: Geer.

MASHT. (2016). *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Blendi.

Musai, B. (2003). *Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë: Pegi.

Musai, B. (2014). *Metodologji e Mësimdhënies*. Tiranë: CDE.

Reynolds, E. (2001). *Guiding Young Children a problem-solving approach*. Boston: Mc Graw Hill.

Selmani, L. & Zisi, A. (2006). *Konceptimi dhe organizimi veprimtarisë mësimore-edukative në arsimin parashkollor*. Tiranë: GEER.

Walsh, B., Kate, Kiranxhiska, Suzana, Gjorgjieva, Ll., Tatjana. (n.d.). *Krijimi i mjedisit për të nxënit për shekullin XXI*. (A. Dimovska, Trans.) Shkup: Shën Kliment Ohridski.

Winsor, P. (2004a). *Mësimi Praktik - Doracak për Studentët e Fakultetit të Edukimit, Programi parashkollor*. Prishtinë.

Winsor, P. (2004b). *Mësimi praktik - Doracak për Studentët e Fakultetit të Edukimit*. Prishtinë: Projekti për aftësimin e mësimdhënësve kosovarë.

Zajazi, T. (2003). *Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies*. Shkup: Vinsent Graphic.

Zuna, A. D. (2003). *Edukimi i parashkollorit në familje*. Prishtinë: DinOr & M.G.

